



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.373/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Valdete Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.V, nga fsh. ... Komuna e ..., për veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr. 1103/2015, dt.30.03.2017, të cilën aktakuzë e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, ka prezantuar i pandehuri D.V, ndërsa pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor e cila ishte e hapur dhe publike, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366, të KPP-së, me dt.13.05.2019, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.24.05.2019;

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

D.V nga i ati, D., e ëma D., e vajzërisë N., i lindur me dt. ... në ..., tani me vendbanim në fsh. ... Komuna e ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i tre fëmijëve, Serbë, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ..., punëtor në ... në

ËSHTË FAJTOR

SEPSE; Me dt.05.12.2011, falsifikon librezën e qarkullimit Serbe ..., për automjetin “Fiat Ulusse 1.9 TD”, ngjyrë e kaltër metalike me vit të prodhimit ... me nr. të VIN: ..., me qëllim të shfrytëzimit të këtij dokumenti si origjinal i drejtohet QRA në Mitrovicë - veri për ta regjistruar automjetin e lartcekur - e venë në lajthim organet e kësaj Qendre dhe arrin ta regjistroj këtë automjet dhe merr targa të regjistrimit ... dhe librezën e qarkullimit ... në emër të të pandehurit D.V, e regjistruar deri me dt.05.12.2012.

Me këtë ka kryer veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit dhe nenit 4, 7, 17, 41, 50, 51, 52, 62, 69, 73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i;

S H Q I P T O N

DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej tre (3) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) vit nëse i pandehuri gjatë kohës së verifikimit nuk kryen vepër penale.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 30 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Gjykata në mbështetje të nenit 69 par. 2 pika 2.7 lidhur me nenin 60 par.1.2 të KPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DËNIM PLOTËSUES

Marrja e sendeve dokumenteve dhe atë; ... dhe ..., tabela e regjistrimit të automjetit ..., si sende të përdorura në kryerjen e veprës penale.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr. 1103/2015, dt.30.03.2017, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.V nga fsh. ... Komuna e ..., për veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjyqtari ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur në dt.11.09.2018 me pas është vazhduar me seancat e shqyrtimit gjyqësor dt.25.04.2019 dhe dt.13.05.2019 me të cilën datë është bërë edhe shpallja publike e aktgjykimit në prezencë të të pandehurit ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët janë njoftuar me të drejtat ligjore në këtë çështje penale, i pandehuri është udhëzuar me të drejtat ligjore në këtë çështje penale në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2,3 të KPP-së.

Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, në seancën e shqyrtimit gjyqësor dt.13.05.2019 edhe në paraqitjen e fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës së parashtruar ndaj të pandehurit, pasi që nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë, duke filluar nga dëshmia e dëshmitarit I.U. si dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës (komplete lënda e tërhequr nga QRA,) ekspertiza nga Agjencia e Kosovës për Forenzike e dt.12.03.2013, rrjedhë dyshimi i bazuar i mirë se i akuzuari ka kryer veprën panel Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par.1 të KPRK-së, andaj nga kjo që u theksua në tërësi mbetem pranë aktakuzës dhe gjykatës i propozoj që të akuzuarin ta shpall fajtorë për veprën penale të kryer sipas aktakuzës dhe ta gjykoj sipas ligjit duke marrë parasysh me rastin e caktimit e dënimit rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj.

I pandehuri D.V, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, në paraqitjen e mbrojtjes së tij, por edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk jam fajtorë për këtë vepër penale, vlerësoj që jam i dëmtuar në rastin konkrete, automjetin e kam blerë nga D.M., nuk kam qene në dijeni se librezja e automjetit ka qenë i falsifikuar, kam qenë i bindur që dokumentacioni ka qenë i rregullt dhe për këtë i jam drejtuar Qendrës së regjistrimit të automjeteve në Mitrovicë që të pajisem me dokumentacionin tjetër, këtë automjet e kam përdorur rreth dy vite, pas njoftimeve nga ana e Policisë se dokumentacioni nuk është në rregull, automjetin ia kam kthyer shitësit D.M. siç e deklarova edhe më lartë i njejtë mi ka kthyer shumën prej 2500€ (euro), ndërsa jemi pajtuar se për shkak të përdorimit të këtij automjetit i njëjtë të mbanë shumën prej 1000€ (euro), pasi që vlera e shitblerjes ka qenë 3500€ (euro), asnjëherë nuk kam pasur probleme me kesi vepra dhe me asnjë vepër tjetër, është hera e parë që prezantoj në gjykatë, kërkoj prej gjykatës që të me liroj nga kjo akuzë .

Pasi që nuk ka pasur propozime të tjera, procedura ka vazhduar me leximin e provave dhe atë janë lexuar respektivisht vështruar; certifikata mbi rregullsinë teknike të automjetit me nr. ..., i dt. 05.12.2011, certifikata mbi rregullsinë teknike të automjetit me nr. ... e dt.05.12.2012, në polisen e sigurimit të auotmjetit në emër të të pandehurit, e dt.05.12.2012, certifikata e regjistrimit të automjetit ... në emër të J.V., certifikata e

regjistrimit të automjetit ... në emër të D.V., fletëpagesat gjithsej 6 kopje, vështrim në kopjen e letërnjoftimit të shitëses J.V., vështrimi në kontratën mbi shitblerjen e automjetit nr. ... i dt.05.12.2011, ekspertiza për ekspertim të dokumenteve dorëshkrimeve të dhëna nga Agjensia e Kosovës së dhënë në Forenzikë e dt.12.03.2013, me konstatimin përfundimtar se dëshmitë nga numri 1 deri ne 16 janë të falsifikuara dhe në numrin 7 është libreza me ..., e personalizuar në emër të V.J.

Pas leximit të provave, Prokurori i shtetit, i pandehurit kanë deklaruar se nuk kanë propozime të tjera sa i përket procedurës së plotësimit të provave dhe procedura ka vazhduar me marrjen në pyetje të të pandehurit.

I pandehuri D.V në mbrojtën e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të dt.13.05.2019, ka theksuar se automjetin e ka blerë nga D.M., Policise i ka dorëzuar kopjet e kontratës që automjeti është blerë nga D.M., respektivisht autorizimin që ka qenë në emrin e tij ndërsa dokumentacioni ka qenë në emër të J.V., nuk i kujtohet se cilit Polic i ka dorëzuar, sa i kujtohet ka qenë vetëm në Qendrën e Kontrollimit Teknik, kontratë ka pasur me D.M., e ka pasur autorizimin nga J., libreza me nr.... në emër të J.V. është ajo librezë, para se me dorëzu dokumentacionin për paisje me dokumentacionin RKS-së, e kam parë se në librezën e leshur nga Republika e Serbisë ka figuruar emri i J.V., por D. ka pasur autorizimin, i pandehuri ka deklaruar se në këtë rast e vlerësoj veten të dëmtuar, automjetin ja kam kthyer D.M. kur e kam kuptuar që dokumentacioni ka qenë i falsifikuar, i njëjti mi ka kthyer parat në shumë prej 2500 euro përveç për shkak të përdorimit të automjetit për dy vite nuk mi ka kthyer shumën prej 1000 euro për këtë jemi pajtuar me të njëjtin.

Pas paraqitjes së mbrojtje nga i pandehuri nuk ka pasur propozime nga palët për plotësimin e procedurës së provave.

Pas procedimit të provave në këtë shqyrtim gjyqësor, paraqitjes së mbrojtjes nga ana e të pandehurit dhe pasi që palët nuk kanë pasur propozime për plotësimin e procedurës së provave është konstatuar e përfunduar procedura e provave, ndërsa pas vlerësimit të provave të proceduara në këtë çështje dhe të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera gjykata në mbështetje të nenit 361 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje si në dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke u provuar se i pandehuri D.V, ka kryer veprën penale të Legalizimit të përmbajtjes se rreme nga neni 403 par.1 i KPRK-së.

Gjykata në veprimet e të pandehurit, vërtetoi se ekzistojnë elementet e veprës penale të Legalizimit të përmbajtjes se rreme nga neni 403 par.1 te KPRK-së, kjo është vërtetuar në baze të provave të administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pasi që nuk është kontestuese për gjykatën dhe është fakt i vërtetuar se librezat e automjetit Fiat Ulusse 1.9 TD”, ngjyrë e kaltër metalike me vit të prodhimit ... me nr. të VIN:..., me targa ..., ka qenë të falsifikuar kjo vërtetohet edhe ne baze te raportit –ekspertizës se konstatuar nga Agjencinë i Forenzikes i Kosovës, dt.12.03.2013, duke e ndërhyrë ne dokumentin origjinal dhe e ka ndryshuar, e ne baze te kësaj i pandehuri duke shfrytëzuar dokumentin e Serbisë ..., te konstatuar me larte, i pandehuri vete e pohon faktin se personalisht i është drejtuar per ne Qendrës se Regjistrimit te Automjeteve ne Mitrovice- Veri ka marre dhe është paisur duke e bartur ketë automjet dhe marre dokumentet e Republikës se Kosovës me ..., me targa ... te gjitha keto vërtetojnë se janë ne emrin e te pandehurit D.V, i cili me veprime te kundërligjshme ka vene ne lajthim personin e autorizuar pranë QRA ne Mitrovicë – Veri dhe kete automjetin e ka bartura ne emrin e tij.

Është e pa bazuar mbrojtja e te pandehurit D.V, duke theksuar se këto automjet e ka blere nga D.M. ne treg ne ... (Republika e Seribise), pasi qe nga provat materiale rezulton se kontratën mbi shitblerjen e automjetit i pandehuri e ka ne mes tij si blerës dhe J.V. si

shitëse nr. ... dt. 05.12.2011, mbrojtja e te pandehurit është e pa bazuar për çka gjykata nuk i ka fale edhe besimin, pasi që te gjitha dokumentacionet si ato te regjistrimit me dokumentacion te lëshuar nga Republika e Serbisë qe figuron ne emrin e J.V., ato me dokumentacionet e Republikës se Kosovës te këtyre automjeteve kane qene ne emrin e te pandehurit.

Provat e proceduara ne ketë çështje gjykata vlerëson se janë ne përputhshmëri me vendimin e marre si ne dispozitivin e këtij aktgjykim për te pandehurin, te konstatuara nga provat materiale andaj gjykata i vlerësoj edhe me rastin e marrjes se aktgjykimit ne shpalljen fajtor te te pandehurit, duke sqaruar rrethanat lidhur me çështjen, duke krijuar një bindje te bazuar te gjykatës me rastin e marrjes se vendimit, se është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale te Legalizimit te përmbajtjes se rreme nga neni 403 par.1 te KPRK-es.

Në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin përjashtuar përgjegjësin penale për të pandehurin në këtë çështje penale në kuptim të nenit 17 te KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-ës, si rrethanë lehtësuese e vlerësoj, sjelljen korrekte pranë gjykatës, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes jo te mire ekonomike kohen e kryerjes se veprës penale, sjelljen e tij pas kohës se kryerjes se veprës penale, ndërsa rrethana rënduese gjykata e vlerësoj mënyrën dhe rrethana se si është kryer vepra penale, gjykata ka vlerësuar me bindjen me te plote se ne rastin konkret rrethana lehtësuese kane dominuar me rastin e përcaktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit, dhe ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 te KPK-es, qe te parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen dhe te beje rehabilitimin e tij, ne parandalimin e personave te tjerë ne kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga te gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është ne përputhshmëri me shkallen e përgjegjësisë dhe te rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për te pandehurin.

Gjykata si nen piken II te dispozitivit te Aktgjykimi ndaj te pandehurit, ka shqiptuar edhe dënimin plotësues –marrjen e sendit, Gjykata duke marre për baze sigurinë juridike po ashtu është sende qe është rezultat i kryerjes se veprës penale dhe i marre ne mënyrë te kundërligjshme, ne mbështetje te nenit 282 par.1 te KPP-es, es ku përcakton se pasuria qe është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marre parasysh edhe gjetjes e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e te pandehurit, neni 69 i KPRK-es, përcakton se Sendet e përdorura apo te destinuara per kryerjen e veprës penale apo sendet te cilat janë rezultat i kryerjes se veprës penale do te konfiskohen, andaj per shkak te këtyre konstatimeve gjykata ka qene e obliguar qe te vendos si nen piken II te këtij Aktgjykimi qe sendet e përdorura te merren -konfiskohen, për shkak edhe te konstatimeve te cekura me larte, ne te kundërtën do te legalizohen veprimet e paligjshme te ndërmarrura mbi këto sende dhe rezultatet e këtij sendi, si nen piken II te dispozitivit te aktgjykimit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e ka marrë konform neneve 450 dhe 451 të KPP-ës, ndërsa lidhur me kërkesën pasurore juridike është vendosur ne mbështetje te nenit 463 te KPP-es duke e udhëzuar palën e dëmtuar per realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.373/2017, dt.24.05.2019

Procesmbajtësja
Valdete Sadiku

Gjyqtari
Bekim Veliqi

UDHEZIMI JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimi të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.